

PROGRAME STUDIMI

I. Programet e studimit me karakter profesional

Programet e studimit me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen në 60 ose 120 kredite formimi dhe kohëzgjatja normale e tyre është një ose dy vite akademike. Pranimi i studentëve në programet e studimit me karakter profesional, është i mundur për çdo kandidat, i cili: është i paisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë; nuk rezulton i regjistruar në një program tjetër studimi.

Njësia bazë përzgjedh studentët fitues, për programet e studimit që ofron, të cilët miratohen nga Dekani. Aplikantët fitues regjistrohen pranë njësisë përkatëse kryesore, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pas përfundimit të regjistrimit të kandidatëve fitues, UGJ-ja përcjell në QSHA listën e studentëve të regjistruar, me qëllim paisjen e tyre me numur matrikullimi (NIM).

[Për t'u njohur me kriteret e pranimi në programet e studimit me karakter profesional, në UGJ, për Vitin Akademik 2023-2024 \(kliko këtu\)](#)

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

Ofron 3 (tre) programe studimi me karakter profesional ([Kliko këtu](#))

a. Program profesional në “Librar dhe bibliotekar”

Titulli akademik i studimit		Diplomë Program Profesional në Librar dhe bibliotekar	
Cikli i studimit		Studime me karakter profesional	
Emri dhe statusi i institucionit		Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime		Shqip	
Kohëzgjatja normale e programit të studimit		2 (dy) vite	
Forma e studimit		Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimi		Sipas kriterëve	

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Një diplomë profesionale “Librar dhe bibliotekar” është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për punësim.

Programi i studimit me karakter profesional “Librar dhe bibliotekar” synon:

Fitimin e njohurive të nevojshme në drejtim të: historisë së letërsisë shqipe dhe historisë së letërsisë së huaj; shkrimit të shqipes; interpretimit dhe orientimit në katalogët dhe bibliografite e botimeve; etnokulturës që ka lënë gjurmë në zhvillimet e shoqërisë njerëzore; historisë së shtypit dhe periodikëve; komunikimit, punës në grup dhe mirësjelljes bazuar te “Kodi i Etikës së librarit dhe bibliotekarit”; organizimit dhe legjislacionit në fushën e bibliotekave dhe të botimit; TIK

(*Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit*) në fushën e bibliotekave dhe të botimit; gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht dhe italisht) në përgjithësi dhe në atë të profesionit në veçanti, për të qenë të aftë të komunikojnë si dhe të përdorin gjuhën e folur e të shkruar në komunikim.

Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim profesional në lëndët e gjuhësisë, letërsisë, kulturës në përgjithësi etj., që do të shërbejnë për studentët e diplomuar qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të kryera në studimet e ciklit të parë në këtë degë apo të tjera të ngjashme me të.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit profesional në "Librar dhe Bibliotekar"

Tipi i veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Njohuri mbi historinë e letërsisë shqipe	6
		Njohuri mbi historinë e gjuhës	6
		Njohuri mbi letërsinë botërore	6
		Totali	18
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Shkrimi i shqipes	8
		Tipologji teksti	8
		Morfologji e gjuhës shqipe	7
		Bibliografi e botimeve	7
		Etnokultura shqiptare	6
		Arkivistikë	5
		Skedim katalogim	5
		Pragmatikë	6
		Histori shtypi dhe periodik	6
		Sintaksë	6
		Totali	64
		C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUE SE
Kulturë gjuhe	6		
Lëndë me zgjedhje në letërsi • Etikë komunikimi • Histori, kulturë dhe qytetërim • Hartim dhe menaxhim projekti	6		
Totali	18		
D	LËNDË PLOTËSUESE	Shprehi gjuhësore dhe teknologji informacioni	6
		Praktikë mësimore profesionale	10
		Totali	16
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	4
		Totali	4
Totali			120

b. Program profesional në “Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Program Profesional në Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme
Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit për përgatitjen e edukatoreve për fëmijërinë e hershme synon:

Formimin e kompetencave shkencore, pedagogjike, metodologjike, didaktike, psikologjike, sociologjike, antropologjike, historiko-filozofike, të komunikimit dhe përdorimit të teknologjive të informacionit, të cilat do të përmbushin objektivat e arsimit në shoqërinë e dijes për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore e kombëtare.

Pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në shërbimet për fëmijërinë e hershme, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e të nxënës dhe të përkujdesjes, në lidhje me karakteristikat e grupmoshës, me veçoritë individuale të fëmijëve, me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës, me përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e edukatorit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.

Aftësimin e studentëve për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional dhe fizik të klasës.

Sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me shkencat sociale dhe ato të edukimit, me synim, zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve, zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të tyre me teknologjinë e informacionit, duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të aftësive komunikuese, psiko-pedagogjike në lëndë të ndryshme, seminare dhe laboratorë.

Të aftësojnë studentët me shprehje teorike dhe praktike në aspektet e përkujdesjes dhe ndërhyrjeve drejtuar fëmijëve me nevoja të veçanta, me njohuri, shprehje edhe vlera në gjuhën e huaj dhe në praktikën mësimore të vëzhguar ose simuluar, në strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme dhe/ose në mjediset e universitetit.

Diploma profesionale “Edukatore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme” mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit për grupmoshat 0-3 vjeç, për të punuar si në çerdhet shtetërore ashtu

edhe në ato private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Sipas kriterëve përkatës mundësohet vazhdimi i studimeve në nivelin e parë Bachelor.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programit i studimit profesional në
“Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme” (0-3 vjeç)

Tipi i veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Psikologji në fëmijërinë e hershme	6
		Pedagogjia e fëmijërisë së hershme	6
		Psikologji edukimi	6
		Totali	18
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Sociologji e përgjithshme	6
		Gjithëpërfshirja në edukim	7
		Antropologji kulturore	6
		Histori e mendimit shqiptar	6
		Modele të ndërmjetësimit didaktik	7
		Formimi gjuhësor dhe komunikimi	6
		Letërsi për foshnjërinë	5
		Histori e teorive për foshnjërinë	6
		Të mësuarit nëpërmjet lojës	5
		Totali	54
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE	Përkujdesjet mjekësore në fëmijërinë e hershme	6
		Formimi trupor dhe metodologjia e lojës	5
		Edukim muzikor	5
		Art pamor dhe didaktikë	5
		Lëndë me zgjedhje: 1.Shkrim dhe menaxhim projekti 2. Arte skenike	3
		Totali	24
D	LËNDË PLOTËSUESE	Laborator informatike	4
		Praktikë mësimore profesionale	14
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	6
		Totali	6
Totali			120

c. Program profesional në “Udhërrëfyes Turistik”

Titulli akademik i studimit

Diplomë Program Profesional në Udhërrëfyes Turistik

Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Oferta e pasur turistike e vendit tonë, orientimi mbi prioritetet ekonomike të Shqipërisë, vëzhgimi dhe studimi i tregut nxitën nismën për të hapur një program profesional në profilin “Udhërrëfyes turistik”.

Ky program synon të përgatisë profesionistë të formuar: me njohuritë e duhura gjeografike, historike si dhe në fushën e udhërrëfimeve turistike; me aftësitë e duhura për drejtimin e udhëtimeve turistike kombëtare, locale, si dhe të specialiteteve të veçanta; me njohuritë e nevojshme në drejtim të kodit të etikës së udhërrëfyesit turistik; me njohuritë e nevojshme në drejtim të legjislacionit për udhërrëfyesit turistik; me njohuritë e nevojshme në drejtim të njohjes së kuadrit institucional e organizativ të sektorit të turizmit.

Të diplomuarit në këtë program profesional mund të punësohen si udhërrëfyes turistik:

- i vetëpunësuar si udhërrëfyes i udhëtimeve turistike;
- në agjensitë e udhëtimeve turistike;
- në zonat e mbrojtura natyrore;
- në sitet arkeologjike-historike;
- në parqet argëtuese;
- për lundrimet, në anijet e pasagjerëve me turistë;
- në institucione dhe organizata të ndryshme publike apo private që veprojnë në fushën e turizmit.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese Program profesional në “Udhërrëfyes Turistik ”

Tipi i Veprimtarisë (A-F)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË	Gjeografi e Shqipërisë	6
		Qytetërimet e lashta	6
		Trashëgimi natyrore	6
		Totali	18
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Turizmi urban dhe rural	6
		Gjeografi e turizmit	6
		Etnografi e shqiptarëve	5
		Marrëdhëniet publike të entiteteve të trashëgimisë kulturore	6
		Gjeografi kulturore	6

		Histori antike e shqiptarëve	3		
		Histori mesjetare e shqiptarëve	3		
		Histori moderne e shqiptarëve	3		
		Histori bashkëkohore e shqiptarëve	3		
		Asetet turistike në Shqipërinë Jugore	5		
		Shërbimet dhe standartet për njësitë turistike	5		
		Marketingu dhe promocioni	5		
		Ndihma e shpejtë dhe menaxhimi i emergjencave	4		
		Shkrim dhe menaxhim projektsh	3		
		Totali	63		
		C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Lëndë me zgjedhje -Histori e Bizantit -Teknika të udhërrëfyesit turistik -Sitet arkeologjike në Shqipëri	5
Komunikimi dhe etika e udhërrëfyesit turistik	3				
Menaxhim biznesi familjar	3				
Lëndë me zgjedhje -Teknologjia e informacionit dhe turizmi -Elemente të hartografisë për udhërrëfyesin turistik -Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik	5				
Totali	16				
D	LËNDË PLOTËSUESE			Gjuhë angleze	8
				Praktikë mësimore profesionale	10
		Totali	18		
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	5		
		Totali	5		
Totali			120		

2. Fakulteti Ekonomik

Ofron 3 (tre) programe studimi me karakter profesional ([Kliko këtu](#))

a. Program profesional në “Asistent Administrativ”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Program Profesional në Asistent Administrativ
Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënje/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim profesional në disiplinat e Administrimit Publik.

Në përfundim të këtij programi, studenti ka mundësitë e mëposhtme të punësimit: vetëpunësim në ndërmarrje të biznesit të vogël; punonjës i kualifikuar në njësi ekonomike të ndryshme për kryerjen e veprimtarive që lidhen me fushën e biznesit; përpunues i dokumentacionit kontabël dhe financiar; regjistruar i dokumentacionit kontabël dhe financiar; magazinier (person përgjegjës për ruajtjen e vlerave materiale pranë njësive ekonomike); arkëtar (person përgjegjës për ruajtjen e vlerave monetare pranë njësive ekonomike); regjistruar i informacionit në programet kompjuterike në fushën e financës dhe kontabilitetit; punonjës i administratës për kryerjen e veprimtarive që lidhen me mbajtjen e llogarisë në njësi ekonomike të ndryshme; punonjës në banka të llojeve të ndryshme për kryerjen e veprimeve të thjeshta që lidhen me sektorin bankar; punonjës pranë shoqërive të sigurimeve; punonjës pranë zyrave private të kontabilitetit; punonjës për hartimin e listë pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese Programi profesional në “Asistent Administrativ”

Veprimtaritë formuese		Lëndët/Modulet	Kredite/ECTS
A	LËNDË BAZË	Bazat e Ekonomisë	6
		Bazat e Marketingut	6
		Baza të Menaxhimit	6
		Totali	18
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	E Drejta e Punës	6
		Sjellje Organizative	6
		Hyrje në Administrim Publik	6
		Etika Administrative	6
		Komunikimi	6
		Drejtim Administrativ Zyre	6
		E-Qeverisja	6
		Baza të Qeverisjes	6
		Menaxhim i Nd. dhe Inst. Publike	6
		Kontabilitet Publik	6
		Totali	60
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE INTEGRUESE	Aplikime Kompjuteri	6
		Baza të Kontabilitetit dhe Financës	6
		Lëndë me Zgjedhje	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Gjuhë e Huaj (Anglisht)	6
		Praktika Profesionale	12
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	6

	Totali	6
Totali		120

b. Program profesional në “Asistent-menaxher në shërbimet turistike”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Program Profesional në Asistent-menaxher në shërbimet turistike
Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Në përfundim të programit profesional “Asistent-menaxher në shërbimet turistike”, studenti ka mundësi për punësim: në të gjithë sektorët e një hoteli, si në resepsion, Food & Beverage, restorant, organizim eventesh, në argëtim; në agroturizëm; në resorte të mëdha turistike; në restorante dhe biznese catering; në biznese që ofrojnë shërbime turistike; në biznese ndihmëse turistike; në sipërmarrje private turistike.

**Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit profesional “Asisten-menaxher në Shërbimet Turistike”**

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Bazat e Turizmit	6
		Bazat e Ekonomisë	6
		Totali	12
	LËNDË KARAKTERIZUESE	Organizimi dhe funksionimi i hotelit	7
		Organizimi dhe funksionimi i restoranteve dhe guzhines	7
		Kontabilitet dhe Kosto e produktit turistik	7
		Marketing i shërbimeve turistike	7
		Aplikime software-i në hoteleri turizëm	7
		Hyrje në menaxhimin e biznesit familjar turistik	8
		Ekonomi e turizmit	8
		Strategji e turizmit	8
		Ligje Turizmi	7
		Totali	66
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/	Statistike Turizmi	6
		Gjeografi Turistike	6

	INTE GRUESE	Lende me zgjedhje: -Sjellje organizative - Investime - Shkrim dhe menaxhim projektsh	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Gjuhe e huaj 1 – Anglisht	3
		Gjuhe e huaj 2 – Italisht	4
		Gjuhe e huaj 1 Anglisht	3
		Gjuhe e huaj 2 – Italisht	3
		Praktike profesionale	5
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim përfundimtar formimi/Punim diplome	6
		Totali	6
Totali			120

c. Program profesional në “Ndihmës Ekonomist”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Program Profesional në Ndihmës Ekonomist
Cikli i studimit	Studime me karakter profesional
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Një diplomë profesionale “Ndihmës Ekonomist” është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për punësim kryesisht në sektorin privat dhe publik.

Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim profesional në disiplinat e Kontabilitet Financës

Programi i studimit me karakter profesional “Ndihmës Ekonomist” synon që studenti të zotërojë aftësi për kryerjen e veprimeve në fushën: e burimeve njerëzore, të menaxhimit dhe marketingut, të kontabilitetit e financës, të shitjeve dhe blerjeve; të kryejë procese pune e veprime të thjeshta në fushën e kontabilitetit, në fushën bankare, në marrëdhënie me të tretët; të organizojë vendin e punës në zyrë si dhe të përdorë mjetet dhe pajisjet kryesore të zyrës; të kryejë detyra që lidhen me procesin e prodhimit; të mbajë dhe rregullojë marrëdhëniet me organet tatimore; të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientët, furnitorët dhe punonjësit; të ketë aftësi komunikuese me shkrim e me gojë për të argumentuar mendimet për çështje të ndryshme; të jetë i aftë të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional; të respektojë

parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar; të jetë i aftë të vlerësojë punën e të tretëve mbi bazën e kritereve të drejta.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit profesional “Ndihmës Ekonomist”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Bazat e Ekonomisë	6
		E drejta e punës	6
		Totali	12
	LËNDË KARAKTERIZUESE	Instrumenta Kalkulues në Biznes	6
		Baza Ligjore e Kontabilitetit	6
		Komunikimi në biznes	6
		Bazat e finances	6
		Kontabiliteti Financiar	6
		Njohuri mbi sistemin e tatim taksave	6
		Bankat dhe sistemi financiar	6
		Kontabiliteti aplikativ	6
		Llogaritja dhe regjistrimi i shpenzimeve	6
		Menaxhim biznesi	6
		Baza të marketingut	6
		Totali	66
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE	Njohuri për programet financiare	6
		Hyrje në informatikë	6
		Lëndë me zgjedhje: 1. Baza të statistikës 2. Shkrim dhe Menaxhim Projektesh	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Gjuhë e huaj	6
		Praktika Profesionale	12
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim përfundimtar formimi/Punim diplome	6
		Totali	6
Totali			120

II. Programet e Ciklit të Parë, Bachelor

Programet e ciklit të parë të studimeve, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë në UGJ është i mundur për çdo kandidat, i cili, është i paisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë; plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshilli të Ministrave dhe kriteret shtesë të

përcaktuara nga njësitë kryesore; nuk rezulton i regjistruar në një program tjetër studimi.

Njësia bazë, përzgjedh studentët fitues, sipas programeve përkatëse, të cilët miratohen nga Dekani. Aplikantët fitues regjistrohen pranë njësisë përkatëse kryesore, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pas përfundimit të regjistrimit të kandidatëve fitues, UGJ-ja përcjell në QSHA listën e studentëve të regjistruar, me qëllim paisjen e tyre me numur matrikullimi (NIM).

Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Studentët që do të përgatitin një punim diplome duhet të përmbushin kriteret që përcaktohen nga njësia bazë në rregulloret përkatëse të programeve të studimit.

[Për t'u njohur me kriteret e pranimit në Ciklin e parë të studimeve Bachelor, në UGJ, për Vitin Akademik 2023-2024 \(kliko këtu\)](#)

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

Ofron 6 (gjashtë) programe studimi të Ciklit të Parë Bachelor ([Kliko këtu](#))

a. “Bachelor” në “Histori – Gjeografi ”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Histori – Gjeografi
Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Histori-Gjeografi, ka si synim të promovojë përgatitjen e kualifikuar të studentëve dhe studiuesve të rinj në fushën e studimeve historike dhe gjeografike.

Në përfundim të këtij programi, studentët duhet të zotërojnë këto kompetenca:

- të kenë njohuri të plota shkencore për zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore dhe dinamikën e zhvillimit të fenomeneve të gjeografisë fizike si dhe të ndryshimeve social-ekonomike;
- të njohin dhe të zotërojnë etapat që ka kaluar procesi i këtij zhvillimi;
- të jenë të aftë të bëjnë analiza shkencore për ngjarjet e shkuara historike dhe fenomenet gjeografike;

- d. të zhvillojnë sensin e ndërgjegjjes historike dhe të përgatiten si pjestarë aktivë të shoqërisë demokratike;
- e. të dine të vlerësojnë dhe të analizojnë ngjarjet kryesore, të cilat kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik e kulturor të një vendi apo të mbarë shoqërisë njerëzore;
- f. të kuptojnë dhe të vlerësojnë lidhjet reciproke ndërmjet vendeve, bashkëpunimin dhe kundërshtitë, përfitimet reciproke ndërmjet qytetërimeve dhe kulturave të ndryshme.

Pas përfundimit me sukses të programit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Histori-Gjeografi, të diplomuarve u mundësohet të ndjekin studimet për Master Profesional në mësuesi, Master i Shkencave në fushat e ngushta studimore të Albanologjisë apo në fushat e studimeve të tjera historike dhe gjeografike.

Mundësitë e punësimit: mësues të historisë dhe gjeografisë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme (pasi të kenë përfunduar Masterin Profesional); specialistë në administratën publike si arkivistë, punonjës në sektorin e trashëgimisë së të mirave materiale dhe kulturore, specialistë të mjedisit, të turizmit etj; teknikë në sektorët përkatës kërkimorë të intitucioneve shkencore.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”

Tipi i Veprimtarisë (A-F)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Bazat e arkeologjisë	4
		Bazat e etnografisë	4
		Dokumentacion arkivor	3
		Gjeografi fizike e përgjithshme	7
		Hyrje në gjeografi humane	7
		Gjeomorfologji e përgjithshme	6
		Histori e Ballkanit	5
		Totali	36
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Histori antike e shqiptarëve	5
		Histori mesjetare e shqiptarëve	6
		Histori antike e botës	6
		Histori e mesjetës botërore	6
		Histori moderne e botës	7
		Histori moderne e shqiptarëve	6
		Gjeografi e popullsisë dhe e vendbanimeve	5
		Gjeografi rurale	4
		Gjeografi urbane	5
		Gjeografi e turizmit dhe mjedisit	6
		Histori e shqiptarëve 1912-1939	5
		Histori e shqiptarëve 1939 e në vazhdim	5
		Histori e shekullit XX	5
		Gjeografi rajonale e Shqipërisë dhe e trojeve	10
		Gjeografi rajonale e botës	10

		Histori e civilizimit joperëndimor	5
		Totali	96
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	Bazat e gjeologjisë	4
		Elemente të hartografisë	5
		Gjeografi e industrisë	6
		Lëndë me zgjedhje në histori -Histori e Bizantit -Histori e institucioneve -Sitet arkeologjike në Shqipëri	3
		Lëndë me zgjedhje në gjeografi -Gjeografi e komunikacionit -Gjeografi politike -Histori e mendimit gjeografik	3
		Histori e marrëdhënieve ndërkombëtare	4
		Totali	25
		D	LËNDË
Bazat e SIG-ut	3		
Metodologji e kërkimeve në terren	3		
Praktikë në terren	3		
Shkrim dhe menaxhim projektsh	5		
Totali	17		
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	6
		Totali	6
Totali			180

b. “Bachelor” në “Gjuhë - Letërsi Shqipe”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Bachelor në gjuhë letërsi shqipe
Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në gjuhë – letërsi shqipe synon:

Të japë njohuri bazë gjuhësore dhe letrare mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet lëndësh mësimore gjuhësore e letrare.

Rritjen e kompetencës shkencore të studentëve në disiplinat teorike, për t’u përgatitur për arsimimin dhe trajnimin e mëtijshëm në fushën e mësuesisë; për njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe për një

trajnim e parapërgatitje për kërkim të pavarur në fushën e gjuhësisë, gazetarisë, kritikës letrare.

Qëllimi i programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore të vendit në përgjithësi dhe të sistemit arsimor në veçanti, të nevojave të mëdha që dikton situata aktuale për mësues e specialistë në shkencat shoqërore në përgjithësi dhe për gjuhën dhe letërsinë shqipe në veçanti, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vullshme të teknologjisë së informacionit, e cila dikton nga ana e saj, objektiva dhe kërkesa të reja në sistemin arsimor të vendit.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi Shqipe”

Tipi i veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Hyrje në gjuhësi	6
		Hyrje në shkencën e letërsisë	6
		Shkrimi i shqipes	8
		Dialektologji	5
		Sociolingustika	5
		Gjuhësi teksti	5
		Totali	35
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Letërsi e huaj 1	8
		Leksikologji	7
		Fonetikë	6
		Filozofi dhe estetikë	8
		Pragmatistikë	5
		Morfologji e gjuhës shqipe	8
		Letërsi e huaj 2(shek. XIX)	8
		Letërsi shqipe e vjetër +Rilindje	8
		Letërsi moderne shqipe	7
		Histori në gjuhësisë botërore	6
		Histori e gjuhës shqipe	5
		Sintaksa	7
		Letërsi e huaj 3(shek.XX)	8
		Letërsi shqipe 2 (bashkëkohore)	8
		Totali	99
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	Etnofolklor	4
		Letërsi arbëreshe	3
		Teori e letërsisë	3
		Letërsi e krahasuar	3
		Disiplina gjuhësore me zgjedhje • Histori e Albanologjisë • Dialektologji arbëreshe • Hartim dhe menaxhim projekti	5
		Totali	22
D	LËNDË PLOTËSUESE-Gjuhë të	Gjuhë dhe qytetërim i huaj	12
		Praktikë në terren gjuhësore dhe	6

	huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.	folklorike	
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	6
		Totali	6
Totali			120

c. “Bachelor” në “ Gjuhë Angleze”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Gjuhë angleze
Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programit i studimit “Bachelor në Gjuhë angleze” sunon:

Të përgatisë specialistë në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë në Gjuhë angleze të aftë të përdorin njohuritë gjuhësore dhe letrare në një nivel të lartë profesional.

Të formojë studentë të përgatitur për perceptimin dhe përvetësimin e njohurive më të thelluara teorike dhe praktike në specialitetin përkatës.

T’u shërbejë si bazë studentëve të diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë të studimeve Master në mësuesi apo Master i shkencave në Gjuhë angleze.

Studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.

Studentët mund të punojnë si: *përkthyes letrarë ose zyrtarë* duke iu përgjigjur më së miri zhvillimeve dhe nevojave të shkrimeve dhe të shkresave në bashkëpunimin e hapur global shkencor dhe administrativ; *interpretë* në shoqërimin e grupeve të ndryshme turistike në një treg të hapur global me interesa të ndryshme për historinë, shoqërinë dhe natyrën shqiptare; *punonjës* në organizma të ndryshëm ndërkombëtarë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë jo vetëm në rolin e përkthyesit-interpretit, por edhe të konsulentit për çështje të ndryshme shoqërore, historike, ekonomike apo politike.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimi “Bachelor në Gjuhë Angleze”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Bazat e gjuhesise	8
		Gjuhe shqipe	10
		Njohuri mbi letersine	8
		Gjuhesi e thelhuar	6
		Totali	32
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Gramatikë angleze I	8
		Analize teksti I	10
		Anglishtja permes prozes /poez/ drames	10
		Gramatikë angleze II	8
		Histori Anglo-Amerikane	8
		Analize teksti II	10
		Letersi Anglo-Amerikane	8
		Leksikologji	8
		Teori & praktike perkthimi	12
		Analize teksti III	10
		Shprehi komunikimi	4
		Totali	96
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Lende me zgjedhje a.Anglisht e folur b.Studim vepre letrare c.Anglishte Biznesi	4
		Lende me zgjedhje a.Shkrim Akademik b.Studime Britanike c.Shkrim dhe menaxhim projektesh	4
		Lende me zgjedhje a.Letersi e krahasuar b.StudimeAmerikane c.Sociolinguistike	4
		Histori e gjuhes Angleze	6
		Letersi shqipe	4
		Totali	22
		D	LËNDË PLOTËSUESE
Aftesim kompjuterik	4		
Gjuhë e huaj II frengjisht	6		
Gjuhë e huaj II frengjisht	6		
Totali	22		
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	8
		Totali	8
Totali			180

d. Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor
Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor KL.1-5”, ofron njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi në fushën e mësuesisë për Arsimin Fillor. Organizohet në jo më pak se 180 kredite. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punimdiplome.

Kërkesat gjithnjë e në rritje për përgatitjen e studentëve në shkollat e larta diktohen nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i vullshëm i shkencës, arsimit dhe teknologjisë së mësimdhënies.

Qëllimi i këtij programi është:

- marrja e njohurive dhe kultivimi i shprehive të nevojshme, shumëplanëshe dhe të shumëllojta, për të drejtuar me sukses procesin e mësimdhënies dhe të nxënit e nxënësve për Arsimin Fillor;
- pajisen me metodologjitë e reja sidomos në fushën e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie, në fushën e pedagogjisë dhe didaktikës, si dhe në paisjen me njohuri në disiplina të ndryshme që lidhen me metodologjinë e arsimit fillor, në mënyrë që të kenë kompetencat pedagogjike të nevojshme për të organizuar dhe menaxhuar me sukses edukimin dhe vlerësimin e nxënësve;
- përgatitjen e specialistëve në fushën e edukimit, mësimdhënies, menaxhimit, organizimit dhe drejtimit të cilët do të zbatojnë konceptin bashkëkohorë për procesin e të nxënit duke i dhënë përparësi rolit aktiv të fëmijëve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave, si dhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë drejtues dhe krijues të situatave të të nxënit.

Të diplomuarit në përfundim të ciklit të studimit paisen me këto kopetenca: me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në Arsimin Fillor; me kompetenca të përgjithshme për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur; me aftësi për të përzgjidhur atë çfarë është më e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit, për të dalluar dijet e domosdoshme, duke mbajtur qëndrime kritike ndaj tyre; me aftësi për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike dhe me kompetenca të reja që i ndihmojnë të zotërojnë botën e sotme dixhitale; të

ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës;

Studentët që do të mbarojnë këtë program studimi do të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut tëpunës. Ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e universitetit si një qendër e kërkimit dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit “ Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Tipi i veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite /ECTS
A	LËNDË BAZË	Psikologji e përgjithshme	6
		Metodologji e mësimdhënies	6
		PsikologjiZhvillimi	6
		PsikologjiEdukimi	6
		Totali	24
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Matematikë 1	6
		Matematikë 2	6
		Gjuhëshqipe 1	6
		Studimi&Shkrimiakademik	5
		Gjuhëshqipe 2	6
		Letërsipërfëmijë	5
		Edukimqytetardhe social ifëmijës	4
		Edukimi me aftësi ndryshe	6
		Njohuri për Historinë e Shqiperise	5
		Njohuri për Gjeografinë e Shqiperise	5
		Didaktika e matematikës	5
		Didaktika e gjuhës dhe leximit	5
		Histori e Mendimit Pedagogjik	6
		Teori dhe ushtrime në biologji-kimi	7
		Teori dhe ushtrime në fizikë	4
		Kujdesi për veten	5
		Didaktika e edukimit fizik	6
		Didaktika e shkencave shoqërore	4
		Arte Skenike	3
		Mendimi kritik dhe krijues	6
		Totali	105
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Art pamor dhe didaktikë	12
		Edukim muzikor dhe didaktikë	8
		Lëndë me zgjedhje: 1.Shkrim dhe menaxhim projekti 2. Aftësim teknologjik	4
		Lëndë me zgjedhje: 1.Teori edukimi	

		2. Kërkim në edukim	
		Totali	27
D	LËNDË PLOTËSUESE	Gjuhë e huaj	5
		Informatikë	3
		Praktikë mësimore profesionale	10
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar /punim diplome	6
		Totali	6
Totali			180

e. Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

Titulli akademik i studimit		Diplomë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	
Cikli i studimit		Studime të ciklit të parë	
Emri dhe statusi i institucionit		Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime		Shqip	
Kohëzgjatja normale e programit të studimit		3 (tre) vite	
Forma e studimit		Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimit		Sipas kritereve	

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ofron njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në fushën e mësuesisë për arsimin parashkollor. Organizohet në jo më pak se 180 kredite. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punimdiplome.

Kërkesat gjithnjë e në rritje për përgatitjen e studentëve në shkollat e larta diktohen nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i vrullshëm i shkencës së arsimit dhe teknologjisë së mësimdhënies.

Qëllimi i këtij programi është:

- të paisen me dijet dhe shprehitë e nevojshme, shumëplanëshe dhe të shumëllojta, për të drejtuar me suksese procesin e mësimdhënies dhe të nxënëit e fëmijëve me qëllim që të jenë qytetarë active të shoqërisë demokratike;
- të pajisen me metodologji të reja sidomos në fushën e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie, në fushën e pedagogjisë dhe didaktikës si dhe të thellojnë njohuritë në disiplina të ndryshme ël idhen me kurriculën e arsimit parashkollor, në mënyrë që të kenë kompetencat pedagogjike të nevojshme për të organizuar dhe menaxhuar me sukses edukimin dhe vlerësimin e fëmijëve;

- c. përgatitjen e specialistëve në fushën e edukimit, mësimdhënies, menaxhimit, organizimit dhe drejtimit sidomos në arsimin parashkollor;
- d. të përgatitë specialist të cilët do të zbatojnë konceptin bashkëkohor për procesin e të nxënës duke i dhënë përparësi rolit aktiv të fëmijëve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave si dhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënës.

Ky program behet gjithashtu i nevojshem nga rëndësia që i është dhënë moshës së fëmijërisë së hershme 3-6 vjeç në edukimin dhe zhvillimin e tyre në përputhje me Ligjin për Sistemin Arsimit Parauniversitar, Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parashkollor, Kurrikulën bërthamë për klasat parapërgatitore dhe arsimin fillor.

Ky program studimi synon që të diplomuarit në përfundim të ciklit të studimit: të pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në arsimin parashkollor; të pajisen me kompetenca të përgjithshme për jetë dhe punësim dhe të zhvillojnë edhe kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur; të aftësohen për të përzgjedhur atë çfarë është më e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit, për të dalluar dijet e domosdoshme duke mbajtur qëndrime kritiken ndaj tyre; të pajisen me aftësi për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike dhe me kompetenca të reja që indihmojnë të zotërojnë botën e sotme dixhitale; të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës;

Studentët që do të mbarojnë këtë program studimi do të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut tëpunës. Ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e universitetit si një qendër e kërkimit dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Psikologji e përgjithshme	6
		Alternativat e edukimitparashkollor	6
		Kurrikula e Arsimit Parashkollor	6
		PsikologjiZhvillimi	6
		PsikologjiEdukimi	6
		Totali	30
		Matematikë	6
		Të mësuarit nëpërmjet lojës	5
		Gjuhëshqipe 1	6

B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Gjuhëshqipe 2	6
		Letërsipërfëmijë	5
		Edukimqytetardhe social ifëmijës	4
		Edukimi me aftësi ndryshe	6
		Njohuri për Historinë e Shqiperise	5
		Njohuri për Gjeografinë e Shqiperise	5
		Didaktika e matematikës	5
		Didaktika e gjuhës dhe leximit	5
		Histori e Mendimit Pedagogjik	6
		Teori dhe ushtrime në biologji-kimi	7
		Teori dhe ushtrime në fizikë	4
		Kujdesipërveten	5
		Didaktika e edukimitfizik	6
		Didaktika e shkencaveshoqërore	4
		Arte Skenike	3
		Mendimikritikdhekrijues	6
		Totali	99
		C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE
Edukim muzikor dhe didaktikë	8		
Lëndëmëzgjedhje: 1.Shkrim dh menaxhim projekti 2. Pedagogji familjare	4		
Lëndëmëzgjedhje: 1.Teori edukimi 2. Kërkiminëedukim	3		
Totali	27		
D	LËNDË PLOTËSUESE		
		Informatikë	3
		Praktikëmësimoreprofesionale	10
		Totali	18
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provimipërgjithshëmpërfundimtar /punimdiplome	6
		Totali	6
Totali			180

f. “Bachelor” në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek ”

Titulli i studimit		Diplomë Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë	
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip	
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite	
Forma e studimit	Me kohë të plotë	

Kushtet e pranimit	Sipas kritereve
--------------------	-----------------

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Qëllimi i programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore të vendit në përgjithësi dhe të sistemit arsimor në veçanti, të nevojave që dikton situata aktuale për specialistë në shkencat shoqërore në përgjithësi dhe për gjuhën, letërsinë dhe qytetërimin grek, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vullshme të teknologjisë së informacionit, e cila dikton objektiva dhe kërkesa të reja në sistemin arsimor.

Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek” ka për objektiva formuese:

- dhënien e njohurive bazë nëpërmjet metodave e parimeve shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet lëndësh mësimore gjuhësore e letrare në gjuhën greke dhe atë zyrtare shqipe;
- rritjen e kompetencës shkencore të studentëve në disiplinat teorike për t’u përgatitur për arsimimin dhe trajnimin e mëtejshëm në fushën e mësuesisë për shkollat në gjuhën amtare të minoritetit grek apo dhe në shkolla të tjera në gjuhën greke në Shqipëri, për njohuri të thelluara teorike dhe praktike që lidhen me gjuhën letërsinë dhe kulturën greke;
- për një trajnim e parapërgatitje për kërkim të pavarur në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe qytetërimit grek, shkencave shoqërore, përkthimit, kritikës letrare.

Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek” i garanton studentit: gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kërkesat e programit të studimit në të gjitha hallkat e drejtimet e tij; mësimdhënie të kualifikuar, literaturë sa më të gjerë dhe bashkëkohore për lëndët e planit mësimor, mjedisin e duhur për pjesëmarrje në kërkim shkencor dhe veprimtari të tjera, transparencë dhe marrëdhënie demokratike; marrjen pjesë në veprimtaritë e programit dhe të universitetit; plotësimin e kërkesave që lidhen me arritjen e objektivave të programit të studimit; kushte të përshtatshme, mjedise, akses interneti.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Folklor	5
		Histori e Greqisë	5
		Arkeologjia dhe kultura në Epir	5
		Historia dhe kultura bizantine	5
		Përkthimi, teoria dhe praktikat e përkthimit	5
		Vështrim diakronik i kulturës greke	5

		Totali	30
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Gjuha greke (morfologji-sintaksë)	12
		Gjuha shqipe (morfologji-sintaksë)	8
		Letërsia e re greke (shek. XI-XVII)	6
		Vërejtje drejtëshkrimore tëgjuhës sëre greke	6
		Letërsia antike greke	11
		Letërsia e re greke (shek. XVII-XIX)	12
		Hyrje në gjuhësi	6
		Leksikologji dhe semantikë	6
		Letërsi e re greke (shek. XX)	6
		Vështrim krahasues i letërsisë greko-shqiptare	6
		Sociolinguistika	5
		Totali	84
		C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE
Lëndë me zgjedhje: -Njohuri mbi artet e bukura dhe muzikën -Teksti dhe analiza e tekstit letrar-Hyrje në PC dhe teknologji të reja	5		
Teoria e letërsisë	5		
Lëndë me zgjedhje: -Letërsia e re shqipe -Dialektologji -Mjedisi në lëndët shkollore të arsimit fillor	5		
Stilistika e tekstit	6		
Lëndë me zgjedhje -Letërsi greke, brezi i viteve 30 -Psikologjia dhe pedagogjia në shkollë -Hartim dhe menaxhim projektsh	5		
Totali	35		
D	LËNDË PLOTËSUESE		
		Teknologji të reja në komunikim	5
		Hyrje në shkencat e edukimit dhe teknologjia e edukimit	12
		Totali	21
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim formimi/Punim diplome	10
		Totali	10
Totali			180

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Ofron 4 (katër) programe studimi të Ciklit të Parë, Bachelor ([Kliko këtu](#))

a. “Bachelor” në “Teknologji Informacioni”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Teknologji informacioni
-----------------------------	---

Cikli i studimit	Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit synon të zhvillojë tek të diplomuarit aftësinë për: t’i përgatitur për pozicionin IT në një gamë të gjerë organizmash; të siguruar një themel të thellë në IT së bashku me aspektet praktike të disiplinës; të sigurojë njohuri të zgjedhjes, dizenjimit, zhvillimit, menaxhimit, integritetit dhe shpërndarjes së sistemeve kompjuterike me qëllim arritjen e objektivave organizative përmes përdorimit të resurseve efektive; t’i paisur me aftësi themelore në IT për tu përgatitur që ti përshtaten dryshimeve teknologjike; të sintetizuar eksperiencat si dhe për të gjeneruar ide; të menduar në mënyrë krijuese; të komunikuar në mënyrë efektive; të gjykojnë dhe arsyetojnë logjikisht; të sigurojnë shërbime informacioni që mund të takojnë nevojat e perceptuara ose të papercptuara të individëve, organizmave dhe komuniteteve; të krijojnë, të ruajnë dhe të vlerësojnë ambientet informative të duhura; të operuar, të zhvilluar, shfrytëzuar dhe për të menaxhuar brenda në grup si dhe të nxisë aftësitë ndërpersonale dhe komunikuese të tyre si një profesionist i teknologjisë së informacionit; të bëhen aktivë në sigurimin e zhvillimit të tyre profesional; të bëhen praktikien reflektues.

Studenti i diplomuar në këtë program studimi mund të punojë si specialist i teknologjisë së informacionit: në administratën publike; administratorë sistemi; mirëmbajtës dhe ekspert mbështetës i rrjetave kompjuterike dhe databazave; zhvillues programesh; dizenjues WEB-i; në institucione bankare, shëndetësore, telekomunikacion etj.; në ndërmarrje të ndryshme ekonomike korporatat e telefonisë mobile dhe kompanitë e ndryshme. Marrja e diplomës “Bachelor” në “Teknologji Informacioni” i jep mundësi studentit për të vazhduar studimet e ciklit të dytë “Master Profesional”/ “Master Shkencor”.

Plani Mësimor sipas veprimtarive formuese Programi i Studimit “Bachelor në Teknologji Informacioni”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Analizë Matematike 1	10
		Algjebër	6
		Strukturë të Dhënash	6
		Sisteme Operative	6
		Programim Web	6
		Totali	34

B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Arkitekturë & Organizim Kompjuteri	6		
		Fizikë	8		
		Programim 1	11		
		Hyrje në Sisteme Programimi	6		
		Analizë Matematike 2	10		
		Probabilitet & Statistikë	6		
		Programim Objekt Oriented	7		
		Matematikë Diskrete	6		
		Programim 2	7		
		Analizë Numerike	6		
		Data Mining	6		
		Bazë të Dhënash	6		
		Rrjete Kompjuterike	5		
		Software Engineering	5		
		Totali	95		
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Dizenjim&Analizë Algoritmesh	7		
		Lëndë me Zgjedhje (Semestri III) 1. Teori Grafesh 2. Gjeometri e Lartë 3. Gjuhë Assembly 4. Kurs Special në Matematikë 5. Shkrim dhe Menaxhim Projektesh	6		
		Inteligjencë Artificiale	6		
		Lëndë me Zgjedhje (Semestri VI) 1. Linux OS 2. Kurs Special në Informatikë 3. Machine Learning	6		
		Totali	25		
		D	LËNDË PLOTËSUESE	Gjuhë e Huaj	6
				Siguri e Sistemeve Informatike	12
Totali	18				
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provimi Përgjithshëm Përfundimtar/ Punim Diplome	8		
		Totali	8		
Totali		180			

b. “Bachelor” në “Biologji Kimi”

Titulli akademik i studimit		Diplomë Bachelor në Biologji Kimi
Cikli i studimit		Studime të ciklit të parë
Emri dhe statusi i institucionit		Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime		Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit		3 (tre) vite

Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

		Lëndë me zgjedhje në histori -Historia e integritit evropian -Historia e vendlindjes -Të drejtat e njeriut -Metodologjia e edukimit	3
		Lëndë me zgjedhje në gjeografi -Të mësuarit e koncepteve kryesore në gjeografinë fizike -Të mësuarit e koncepteve kryesore në gjeografinë humane -Të mësuarit e koncepteve kryesore në gjeografinë rajonale -Të mësuarit e koncepteve kryesore mjedisore në gjeografi	3
		Totali	36
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktikë mësimore profesionale	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim përfundimtar formimi ose punim diplome	12

	Totali	12
Totali		120

g. “Master “ në “Mësues në Arsimin Special”

Titulli akademik i studimit	Diplomë Master Mësues në Arsimin Special
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i ciklit të dytë të studimit ofron zgjerimin dhe thellimin në mënyrë më specifike dhe inovatore të njohurive teorike dhe praktike në fushën e edukimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi ndryshe/nevoja të veçanta/vështirësi në të në formimin e tyre të përgjithshëm.

Programi është riorganizuar e zhvilluar në mënyrë të tillë, që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special.

Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre, gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre në grupet e interesuara.

Nëpërmjet këtij programi studentët do të kenë mundësinë për të punuar mësues ndihmës në institucione të arsimit parauniversitar apo në qendra të specializuara për fëmijë me vështirësi në të nxënë/aftësi ndryshe/nevoja të veçanta në pozicione të ndryshme mësimdhënëse por edhe drejtues: mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit, në qendra ditore dhe qendra rezidenciale si terapist zhvillimi. Mund të punojë gjithashtu në qendra zhvillimi duke qenë pjesëtar i ekipeve multidisiplinare për vlerësimin dhe ofrimin e terapive mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta, si edhe në institute/qendra kërkimore profesionale të fokusuar në fushën e edukimit gjithëpërfshirës.

Në përfundim të këtij program të ciklit të dytë të studimi, *Master professional në “Mësues në Arsimin Special”, studenti do të marrë: Diplomë universitare me titull: Master profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Suplementin e diplomës, ku do të përfshihen detaje të programit akademik që ka ndjekur si dhe*

vlerësimet akademike.

Nëpërmjet këtij programi do të adresohen aspektet e gjithëpërfshirjes në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, ku të diplomuarit do të specializohen për të kuptuar karakteristikat e veçanta të individëve duke ju qasur atyre në mënyrë shkencore dhe holistike. Roli i mësuesit ndihmës tashmë merr një rëndësi të veçantë për të gjitha vendet e civilizuara dhe në mënyrë specifike edhe në sistemin tone arsimor, i cili shfaq mangësi dhe nuk i përgjigjet cilësisht nevojave të fëmijëve me aftësi ndryshe/nevojatëveçanta/ vështirësi në të nxënë.

Programi aftëson të diplomuarit të ofrojnë mbështetje thelbësore në nivel mikro në klasë dhe mbështetjen në nivel makro në jetën e tyre në shoqëri me qëllim zvogëlimin e përjashtimit dhe marginalizimi të tyre.

Në mënyrë më specifike program ka për qëllim përgatitjen e studentëve: për të qenë kontribuues aktivë në procesin e realizimit të gjithëpërfshirjes në sistemin parauniversitar; për të ndihmuar shkollat gjatë procesit të vetëvlerësimit, të analizës dhe të zhvillimit, i cili realizohet nga stafi drejtues, mësuesit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti; për të përcaktuar rrugët që çojnë në zvogëlimin e pengesave në procesin e të nxënës dhe në pjesëmarrjen aktive për çdo nxënësi të shkollës; për të zhvilluar potencialin intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve me aftësi ndryshe për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës; për të vlerësuar identifikimin e problemeve, si dhe për të përcaktuar realizimin e përparësive që synojnë gjithëpërfshirjen; për të njohur dhe zbatuar pedagogjinë me në qendër nxënësin duke ndihmuar krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të të nxënësit. për të bashkëpunuar me mësuesin e klasës, psikologun, punonjësin social të shkollës dhe prindërit; për të promovuar ambiente të përshtatshëm për të nxënë për të gjithë; për menaxhimin e grupit të integruar në procesin e gjithëpërfshirjes; për të demonstruar gatishmëri dhe shkathtësi, për zhvillimin e projekteve në institucionet arsimore, duke zhvilluar shkathtësi për hulumtime në mjediset shkollore dhe më gjerë.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit Master në “Mësues në Arsimin Special”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ECTS
A	LËNDË BAZË	Motivimi dhe produktiviteti	6
		Psikologjizhvillimi e avancuar	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Logopedia	6
		Çrregullime dhe terapi e të folurit	6
		Strategji didaktike në edukimin special	6
		Mësimdhënia e diferencuar në edukimin special	6
		Vështirësi në të nxënë-Disleksia	6
		Komunikimin në edukimin special	6
		Metodat psikodiagnostikues në edukimin special	7
		Terapi profesionale për fëmijë dhe adoleshentë	7

		Totali	50
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Gjithëpërfshirja në edukimin	6
		Sociologji në edukim	6
		Zhvillim kurrikule	6
		Lëndë me zgjedhje: 1.Terapi arti dhe loje 2. Terapinëpërmjetmuzikës	6
		Edukim qytetar	6
		Lëndë me zgjedhje: 1.Metodat e kërkimit në edukimin special 2.Therapia nëpërmjet edukimit fizik	4
		Totali	34
D	LËNDË PLOTËSUESE	Teknologjia e informacionit dhe komunikimi në edukim	4
		Praktikëprofesionale	8
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provimi i përgjithshëm përfundimtar / punim diplome	12
		Totali	12
Totali			120

Master Profesional ([Kliko këtu](#))

a. “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Të diplomuarit në përfundim të ciklit të studimit:

Pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në arsimin fillor; me kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë si dhe të zhvillojnë edhe kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur.

Aftësohen të përcaktojnë se mbi çfarë baze do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet, si do të përzgjidhet ajo që është e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit.

Aftësohen për strukturimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për një qëllime të caktuara;

për të dalluar dijet e domosdoshme dhe të mbajnë qëndrime kritike ndaj tyre; të eksplorojnë dhe të hulumtojnë kuptimin e përmasave të ndryshme të jetës së përditshme; të pajisen me aftësi për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike dhe me kompetenca të reja që i ndihmojnë, të zotërojnë botën e sotme dixhitale; të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria.

Të diplomuarit nga ky program nivelit të dytë Master Profesional mund të punësohen në institucionet publike apo private të arsimit fillor; në pozicione të ndryshme mësimdhënëse por edhe drejtuese: mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit etj.

**Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
“Master Profesional” në “Mësues në Arsimin Fillor”**

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite / ECTS
A	LËNDË BAZË	Motivimi dhe produktiviteti	6
		Totali	6
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Diversiteti e komunikimi në klasë	6
		Familja dhe komuniteti në edukim	6
		Zhvillim kurrikule	6
		Administrimi i arsimit dhe legjislacioni	6
		Totali	24
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE	Gjithëpërfshirja në edukimin	6
		Teknologjia e informacionit dhe komunikimi në edukim	6
		Lëndë me zgjedhje: 1. Etika e Mësuesit 2. Psikologji shkollore	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktikë profesionale	6
		Totali	6
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar/punim diplome	6
		Totali	6
Totali			60

b. “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke”

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor Gjuhën Greke”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	1 (një) vit
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke” organizohet në përgjegjësinë e Departamentit të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek në Universitetin “E. Çabej” Gjirokastër.

Reflekton nëvojat e arsimit fillor në gjuhën amtare greke, të evidentuara nga studimi i këtij Departamenti dhe obligimet që burojnë nga Reforma në arsimin parauniversitar.

Përmbajtja e programit është hartuar duke patur parasysh marrëdhënien dialektike midis objektivave formuese dhe kompetencave profesionale që duhet të fitojë studenti në përfundimin me sukses të këtij programi, me qëllim që të vihen më mirë në funksion të formimit, njohurive, aftësive dhe kompetencave të parashikuara në kurrikulën e re të arsimit parauniversitar.

Duke marrë në konsideratë parimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, niveli 7, në program parashikohen njohuri të specializuara dhe të avancuara në përputhje me këtë nivel si përsa u përket lëndëve të mirëfillta teoriko-shkencore, ashtu edhe ato pedagogjiko-didaktike.

Studenti që përfshihet në këtë program studimi, bëhet objekt dhe subjekt i njohurive teorike dhe praktike të planit mësimor të programit që lidhen:

- me njohuritë shkencore përmbajtësore të lëndëve të zhvilluar në gjuhë amtare, por edhe me gjerë. Në planin mësimor të programit janë përfshirë dhe lëndë me prirje bashkëkohore si fusha të multikulturës, realitetit dygjuhësor (biling), bashkejtesës në harmoni e mirëkuptim, përdorimit të teknologjive të reja etj.
- me njohuritë didaktike dhe pedagogjike, që si mësues i ardhshëm t’i transmetojë ato në mënyrë të suksesshme tek nxënësit.

Në funksion të këtij qëllimi egziston një kombinim efektiv midis komponenteve mësimorë, në auditor dhe jashtë tij, atyre në nivelin e parë të studimit dhe të planit mësimor të këtij programi, si edhe programit të studimit në terësi (praktikave, projekteve, kërkimeve, detyrave studimore) ku pjesëmarrja e studentit del në plan të parë.

Komponenti i njohurive synon njëkohësisht të përbëjë bazën për kultivimin tek studentët të aftësive individuale të domosdoshme dhe të avancuara për zgjidhjen në mënyrë krijuese të problemeve teorike, didaktike e pedagogjike përgjatë ushtrimit të profesionit të mësuesit, si edhe aftësive që i nëvojiten për kërkim dhe inovacione në këtë fushë specializimi.

Ky sistem njohurish dhe aftësish parashikohen në program si një garanci për përfitimin nga studenti të kompetencave personale, funksionale, profesionale dhe etike, aq të domosdoshme për integritetin e një mësuesi, por edhe me synim që këto cilësi të transmetohen nëse tek nxënësit.

Gjithashtu, programi synon që studenti: të aftësohet për procesin e mësimdhënies për nivelin e shkollës së arsimit fillor; të jetë i aftë për të punuar në grupe shoqërore me karakteristika të veçanta sociale, kulturore e psikologjike; të aftësohet për të zbërthyer planet dhe programet mësimore të arsimit parauniversitar; të jetë në gjendje të hartojë planet edukative të klasës në përputhje me temperamentin dhe veçoritë psiko - sociale të nxënësve; të aftësohet si një menaxhues kompetent për harmonizimin e problemeve shkollë – familje – komunitet; të jetë i aftë të marrë përsipër për të zgjidhur problematika të ndryshme që kanë të bëjnë me problemet e shkollës; të jetë në gjendje që njohuritë që zotëron në fushën e gjuhës dhe letërsisë greke t'i harmonizojë me edukimin qytetar; të harmonizojë njohuritë që përcjell te nxënësi në përputhje me të qenit qytetar; të evidentojë dhe edukojë frymën e integritit, globalizmit, tolerancës e të jetuarit në harmoni.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
“Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite / ECTS
A	LËNDË BAZË	Letërsia dhe kultura në minoritetin grek	3
		Letërsia moderne greke	3
		Përdorimi i drejtë i gjuhës greke	4
		Totali	10
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Mësuesi, mësimdhënja dhe procesi i të nxënit	6
		Metodologjia e gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore	8
		Metodologjia e mësimdhënjes së lëndëve shkencore	5
		Totali	19
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Shkolla, familja, komuniteti, arsimi dhe legjislacioni	7
		Plotësim dijesh në matematikë	4
		Plotësim dijesh, art pamor-muzikë	4
		Lëndë me zgjedhje -Njohuri për vendlindjen -Mjedisi kulturor dhe shkolla -Teksti, gjuha dhe stili i tekstit në komunikim -Hartim dhe menaxhim projekti	4
		Totali	19
D	LËNDË PLOTËSUESE	Teknologji informacioni në komunikim	3
		Praktikë mësimore profesionale	4
		Totali	7
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim përfundimtar formimi/Punim diplome	5
		Totali	5

Totali		60
---------------	--	-----------

Master i Shkencave (Kliko këtu)

a. “Master i Shkencave” në “Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike”

Titulli akademik i studimit		Diplomë “Master Shkencave” në “Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike”	
Cikli i studimit		Studime të ciklit të dytë	
Emri dhe statusi i institucionit		Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime		Shqip	
Kohëzgjatja normale e programit të studimit		2 (dy) vite	
Forma e studimit		Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimit		Sipas kriterëve	

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Qëllimi i këtij programi të përbashkët është të ofrojë një formim profesional përmes njohurive komplekse, të cilat, në tërësinë e tyre, fokusohen tek shkencat e arkeologjisë dhe menaxhimi i pasurive arkeologjike, historike dhe kulturore. Këto njohuri do t’i shërbejnë studentëve të diplomuar jo vetëm në aspektin e punësimit në tregun kombëtar dhe vendeve të BE-së, por edhe si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të kryera në studimet e ciklit të dytë në këtë programe të tjera të ngjashme me të.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike” me kohë të plotë (120 ECTS) synon të pajisë studentin me:

- aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe operative që lidhen me sektorët e arkeologjisë dhe të historisë së artit antik, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tematikave që ofrojnë trevat si shqiptare dhe italiane e më gjerë;
- aftësi në sektorët e administrimit, konservimit dhe restaurimit të pasurive arkeologjike, artistike, dokumentare, monumentale etj;
- aftësi në përdorimin e mjeteve informatike dhe të komunikimit elektronik, për të përpunuar monumentet dhe sitet arkeologjike, për të bërë klasifikimin e gjetjeve dhe trajtimin e pamjeve (imazheve), si dhe për të bërë administrimin informatik të materialeve të shkruara;
- aftësi për të përdorur në mënyrë të rrjedhshme, të shkruar dhe të folur, të paktën një nga gjuhët e Bashkimit Europian;

Një diplomë universitare e ciklit të dytë me titull: “Master i Shkencave” në “Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike” është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për punësim, si

specialistë në:

- zyrat teknike të enteve publike: Ministria e Kulturës, Qarqet, Bashkitë etj.;
- institucionet e lidhura me ruajtjen, menaxhimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike;
- Instituti i Monumenteve të Kulturës, drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës, parqet arkeologjike, zyrat e trashëgimisë kulturore, sektorët përkatës në Akademinë e Shkencave etj.;
- në organizmat private që kanë për objekt studimin dhe menaxhimin e vlerave arkeologjike;
- në universitete vendase dhe të huaja që kanë për objekt studimi trashëgiminë kulturore.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
“Master i shkencave” në “Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike”

Tipi i Veprimtarisë (A-F)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Teoria e studimit arkeologjik dhe studime bashkëkohore në arkeologji	8
		Totali	8
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Historia e mendimit arkeologjik	8
		Metoda të thelluara të studimit arkeologjik	8
		Arkeologjia e shoqërive paraurbane	4
		Arkeologjia e shoqërive urbane	4
		Arkeologjia e Antikitetit të Vonë dhe e Mesjetës	7
		Parime të administrimit të pasurive arkeologjike	8
		Letërsia e vjetër greke e romake	7
		Prehistoria e Ballkanit	7
		Prehistoria e Shqipërisë	7
		Civilizimi Bizantin	6
		Totali	66
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Etnoarkeologjia	5
		Gjeoarkeologjia	5
		Qytetërimet e lashta	3
		Gjeografia antike	3
		Arkeologjia klasike	3
		Lëndë me zgjedhje -Arkeologjia e provincave romake -Numizmatika -Mitologjia	3
		Totali	22
		Praktikë në terren	6
		Praktikë në terren	6
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Punim diplome	12
		Totali	12
Totali			120

- b. **“Master i Shkencave” në “Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC”**
(Program i përbashkët me Universitetin e Maçeratës, Itali)

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master Shkencave” në “Arkeologji
-----------------------------	---

Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC”	
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Italisht
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Qëllimi i këtij programi të përbashkët është të ofrojë një formim profesional përmes njohurive komplekse, të cilat, në tërësinë e tyre, fokusohen tek shkenca e arkeologjisë dhe menaxhimi i pasurive arkeologjike, historike dhe kulturore. Këto njohuri do t'i shërbejnë studentëve të diplomuar jo vetëm në aspektin e punësimit në tregun kombëtar dhe vendeve të BE-së, por edhe si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të kryera në studimet e ciklit të dytë në këtë degë apo të tjera të ngjashme me të.

Programi i përbashkët i studimit Master i shkencave “*Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore-ASPIC*”, (me kohë të plotë, 120 ECTS) synon të pajisë studentin me:

- aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe operative që lidhen me sektorët e arkeologjisë dhe të historisë së artit antik, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tematikave që ofrojnë trevat si shqiptare dhe italiane e më gjerë;
- aftësi në sektorët e administrimit, konservimit dhe restaurimit të pasurive arkeologjike, artistike, dokumentare, monumentale etj;
- aftësi në përdorimin e mjeteve informatike dhe të komunikimit elektronik, për të përpunuar monumentet dhe sitet arkeologjike, për të bërë klasifikimin e gjetjeve dhe trajtimin e pamjeve (imazheve), si dhe për të bërë administrimin informatik të materialeve të shkruara;
- aftësi për të përdorur në mënyrë të rrjedhshme, të shkruar dhe të folur, të paktën një nga gjuhët e Bashkimit Europian;

Një diplomë universitare me titull: “*Master i shkencave në Histori dhe arkeologji për inovacion*” dhe “*Administrim i pasurive kulturore historike dhe arkeologjike*” është mjaft fleksibël përsa u përket mundësive që kanë studentët për punësim, si specialistë që mund të punësohen në:

- zyrat teknike të enteve publike: Ministria e Kulturës, Qarqet e rretheve, Bashkitë etj.;
- institucionet e lidhura me ruajtjen, menaxhimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike;

- c. Institutin e Monumenteve të Kulturës, drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës, parqet arkeologjike, zyrat e trashëgimisë kulturore, në institute të Akademisë së Shkencave që kanë për objekt studimi trashëgiminë kulturore etj.;
- d. në organizmat private që kanë për objekt studimin dhe menaxhimin e vlerave arkeologjike;
- e. në universitete vendase dhe të huaja që kanë për objekt studimi trashëgiminë kulturore.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
“Master i shkencave” në “Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore-ASPIC”

Tipi i Veprimtarisë (A-F)		Lëndët/Modulet	Kredite/ECTS
A	LËNDË BAZË	Epigrafia latine	6
		Arkeologjia e Evropës juglindore dhe e Adriatikut	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Epigrafia greke	6
		Gjeografia humane	9
		Muzeologjia dhe Muzeografia	6
		Gjeografia historike	9
		Arkeologjia e krishterë dhe mesjetare	6
		Metodologjitë e kërkimit arkeologjik	6
		Qytetërimi bizantin	6
		Historia e Romës dhe e Mesdheut antik	6
		Arkeologjia klasike	6
		Totali	60
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	1. Aktivitete formuese të zgjedhura lirisht nga studenti -Teoria dhe historia e restaurimit -Historia e epokës së iluminizmit -Historia e mendimit arkeologjik -Arkeologjia e shoqërive paraurbane dhe urbane	6
		2. Aktivitete formuese të zgjedhura lirisht nga studenti -Antikiteti grek -Ekonomia dhe administrimi i trashëgimisë kulturore -Numizmatika -Arkeologjia dhe historia për didaktikën e muzeut dhe parkut arkeologjik	6
		Etnoarkeologjia	4
		Lëndë me zgjedhje -Historia e Evropës mesjetare -Historia e artit evropian -Historia ekonomike -Historia e Evropës moderne	4
		Lëndë me zgjedhje -Gjeografia fizike dhe gjeomorfologjia -Gjeologjia e aplikuar -Mitologjia -Prehistoria e Shqipërisë	4
		Totali	24
	LËNDË PLOTËSUESE	Aftësi gjuhësore	3

D		Praktikë gërmimesh arkeologjike në Hadrianopolis	3
		Praktikë gërmimesh arkeologjike në luginën e Drinos	6
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Punim diplome	12
		Totali	12
Totali			120

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Ofron 1 (një) program Master Profesional ([Kliko këtu](#))

“Master Profesional” në “Shkencat Infermierore”

Titulli akademik i studimit Diplomë “Master Profesional” në “Shkencat Infermierore”	
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	1 (një) vit
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Programi i studimit Master Profesional në “Shkencat Infermierore” që çojnë drejt marrjes së Diplomës Master Profesional në “Shkencat Infermierore”, organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve(ECTS).

Qëllimi i Programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore të vendit në përgjithësi dhe sistemit shëndetësor në veçanti, të nevojave që dikton situata aktuale për infermierë, mami, teknike laborator, teknike imazherie dhe fizioterapistë, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vullshme të çdo shërbimi shëndetësor që dikton nga ana e vet, objektiva dhe kërkesa të reja në sistemin shëndetësor.

Objektivat e këtij program janë:

- Të përftojë njohuri bazë dhe program cilësor për të përgatitur dhe plotësuar formimin për infermierë, mami apo teknicienë në fushat kryesore mjekësore, duke u bazuar dhe mbështetur në ciklin e parë 3 vjeçar të studimeve universitare.
- Të paisë të diplomuarit me njohuri, shkathtësi, shprehje dhe vlera praktike bashkëkohore të domosdoshme për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës në infermieri, mami dhe

teknikë shëndetësore dhe sektorët e tjerë të administratës shëndetësore publike apo private dhe ti përgatisë ata për karrierat e mëtejshme respektive.

- c. Të ofrojë mësimdhënie të ndërmjetme, duke integruar teorinë dhe praktikën dhe të zhvillojë potencialet e studentëve j përmes përjasjeve të të mësuarit ndërdisiplinar.
- d. Të krijojë mundësitë për futjen e informacionit të ri nga mjekësia, i cili do ta bëjë gjeneratën e ardhshme të specialisteve të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe perspective në shëndetesi.
- e. të rritë kompetencat mësimdhënëse të departamentit dhe të studentëve për të ndërmarrë kërkime të përshtatshme, duke synuar dhe rritjen e rolit të universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit në rajon.

Mundësit e punësimit:

Studentët e diplomuar në këtë program mund të punësohen:

- a. Infermierë në pavionet spitalore.
- b. Infermierë në poliklinikat e specialiteteve.
- c. Infermierë në Qendrat Shëndetësore dhe ambulancat e tyre.
- d. Specialistë infermiorë në Drejtoritë e Shëndetit Publik.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
“Master Profesional në Shkencat Infermiorë”

Tipi i Veprimtarisë (A-F)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Menaxhimi i infeksioneve nozokomiale	5
		Totali	5
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Menaxhimi i urgjencave pediatrike	5
		Menaxhimi i pacientëve në mjekësinë interne	5
		Menaxhimi i pacientit kirurgjikal	7
		Menaxhimi i pacientëve në Obstetrikë – Gjinekologji	5
		Totali	22
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE	Lëndë me Zgjedhje (Semestri II)	5
		Teknikat infermiorë bashkëkohore	10
		Totali	15
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktikë profesionale	6
		Totali	6
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar/ Punim Diplome	12
		Totali	12

Totali		60
---------------	--	-----------

3. Fakulteti Ekonomik

Ofron 3 (tre) programe të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe një program “Master i Shkencave”.

Master Profesional ([Kliko këtu](#))

a. “Master Profesional” në “Turizëm”

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master Profesional” në “Turizëm”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera përkatëse integruese. Programi synon fitimin e njohurive të thelluara në fushën e turizmit si specialistë të aftë për të zbatuar me sukses strategjitë dhe politikat e turizmit të qëndrueshëm.

Në përfundim të këtij programi, studenti ka mundësi për punësim si:

- Menaxher në sipërmarrje private turistike;
- Konsulent i biznesit turistik;
- Nëpunës i administratës lokale/qendrore të turizmit;
- Specialist në agjensi turistike/Tour Operatorë.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Turizëm”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)	Lëndët/Modulet	Kreditet/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Ekonomiks Menaxherial
		6

		Menaxhim burimesh njerëzore në industrinë e turizmit dhe mikpritjes	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Turizmi dhe Trashëgimia Natyrore	6
		Turizmi dhe industriat turistike	6
		Menaxhim destinacionesh turistike	6
		Turizmi dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri	6
		Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm	6
		Menaxhimi i biznesit familjar në turizëm	6
		Turizmi dhe zhvillim rural i qëndrueshëm	6
		Ekonomia e turizmit	6
		Totali	48
C	LËNDË NDËRDISCIPLINORE/ INTEGRUESE	Marketingu i turizmit	6
		Sjellje konsumatore në turizëm	6
		Politikat në turizëm	6
		Menaxhimi i cilësisë në turizëm	6
		Lëndë me zgjedhje: Menaxhim projektesh Sistemet e informacionit të menaxhimit Marketingu i shërbimeve	6
		Totali	30
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktikë Profesionale	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Punim diplomë/Provimi formimi	18
			18
Totali			120

b. “Master Profesional” në “Administrim-Publik”

Titulli akademik i studimit Diplomë “Master Profesional” në “Administrim-Publik”	
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Një diplomë në Master Profesional në Administrim Publik është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për karrierë dhe punësim. Qëllimi i programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të

zhvillimeve dhe ndryshimeve ekonomiko- shoqërore të vendit në përgjithësi, niveli i lartë i globalizimit dhe nevoja për të qenë pjesë aktive e tij, të kërkesave të tregut për specialistë të ekonomisë të aftë për zgjidhjen e problemeve në fushën e administrimit publik në kuadër të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë së informacionit.

Programi i studimit i Ciklit të Dytë në Administrim Publik (me kohë të plotë) synon:

- përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë e nevojshme rreth organizimit dhe funksionimit të sektorit publik;
- aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe t'i përgatisë ata për karrierat e mëtejshme respektive;
- përgatitjen e specialistëve të aftë në hartimin e politikave publike dhe për zbatimin korrekt të tyre;
- ofrimin e një mësimdhënie bashkëkohore duke integruar teorinë me praktikën dhe raste studimore moderne.

Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të grupuara në kategoritë e mëposhtme:

- lëndë bazë, të cilat marrin përsipër formimin e përgjithshëm dhe përgatitjen metodologjike;
- lëndë karakterizuese, të cilat lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash janë disiplina të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- lëndë plotësuese, të fokusuara për njohje të gjuhës së huaj, aftësive informatike, praktika profesionale;
- detyrime përmbyllëse (punimi i diplomës ose provimi përfundimtar), sipas përcaktimeve në aktet rregullatore të universitetit.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit “Master Profesional” në “Administrim Publik”

	Tipi i Veprimtarisë (A-E)	Lëndët	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Drejtimit i Shpërblimit	6
		Ekonomiks Menaxherial	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Kontabilitet Publik	7
		Etika në Administratën Publike	6
		Menaxhimi Financiar në Sektorin Publik	7
		Auditimi në Sektorin Publik	7
		Komunikimi dhe Marrdhenia me Publikun	6
		Ekonomiks Publik	6
		Planifikim Strategjik në Sektorin Publik	6

		Totali	45
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Menaxhim Projektesh	6
		Sistemet e Informacionit te menaxhimit	6
		Lidership	6
		E Drejte Pune dhe Njohuri mbi Sherbimin Civil	6
		Administrim Fiskal	6
		Lende me Zgjedhje	6
		Totali	36
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktika Profesionale	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Punim Diplome/ Provim Formimi	15
		Totali	15
Totali			120

c. “Master Profesional” në “Kontabilitet-Financë”

Titulli akademik i studimit		Diplomë “Master Profesional” në “Kontabilitet-Financë”	
Cikli i studimit		Studime të ciklit të dytë	
Emri dhe statusi i institucionit		Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime		Shqip	
Kohëzgjatja normale e programit të studimit		2 (dy) vite	
Forma e studimit		Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimit		Sipas kriterëve	

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Objekti kryesor i këtij programi studimi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë, me cilësi dhe shprehje të larta teknike dhe profesionale në fushat e financave dhe kontabilitetit. Programi Master Profesional në Kontabilitet-Financë është me natyrë aplikative dhe ofron formim kryesisht praktikë, për arritjen e objektivave profesionale në fushat e mësimdhënies, me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri të thelluara të kuadrit zbatues në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit, për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale.

Në fokusin e tij të plotë, ky program studimi gërrsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, si dhe t’i ekspozojë ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e financave dhe kontabilitetit, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur fuqishëm nga praktikat më të mira.

Programi Master Profesional në Kontabilitet – Financë i profilizon studentët në fusha të ndryshme si:

a. drejtimi financiar i bizneseve dhe vendimmarrja financiare;

- b. hartimi, përdorimi, analiza dhe interpretimi i pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar;
- c. planifikimi dhe administrimi i tatimeve sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- d. matja, vlerësimi, analiza dhe menaxhimi i riskut;
- e. vlerësimi i investimeve dhe përzgjedhja e tyre;
- f. dizenjimi, përdorimi dhe auditimi i sistemeve të kontabilitetit;
- g. Planifikimi, organizimi dhe menaxhimi i procedurave të auditimit të brendshëm dhe të Jashtëm.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit i Ciklit të Dytë “Master Profesional” në Kontabilitet Financë

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Ekonomiks Menaxherial	6
		Drejtimi i shpërblimit	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	Tregjet dhe Institucionet Financiare	6
		Analiza e Pasqyrave Financiare	6
		Drejtimi Financiar Ndërkombëtar	6
		Teknika Bankare	6
		Auditim	6
		Drejtimi Financiar i Avancuar	6
		Kontabiliteti i Avancuar	6
		Drejtim Portofoli	6
		Totali	48
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	Sistemi Tatimor Tregëtar	6
		Menaxhim Projektesh	6
		Analizë Investimesh	7
		Organizimi i Sistemeve të Kontabilitetit dhe Kontrollit	7
		Lëndë me zgjedhje: 1. Kontabiliteti Kosto Drejtimi i avancuar 2. Vlerësim Pasurie 3. Sistemet e informac. dhe Manaxhimit	7
		Totali	33
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktikë Profesionale	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Provim i përgjithshëm përfundimtar /Punim diplome	15
		Totali	15
Totali			120

Master i shkencave (Kliko këtu)

- d. “Master i Shkencave” në “Financë - Kontabilitet”

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master i Shkencave” në “Finance – Kontabilitet”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Një diplomë në “Master i Shkencave” në Financë-Kontabilitet është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për karriere dhe punësim si dhe siguron njohuritë themelore të kërkuara për të ndjekur një diplomë kërkimore (Ph.D.) në fushat respektive.

Programi i studimit të Ciklit të Dytë në “Master i Shkencave” në Financë-Kontabilitet (me kohë të plotë, 120 ECTS) synon të përgatisë specialistë për:

- tregjet dhe institucionet financiare;
- realizimin dhe analizën e investimeve publike dhe private;
- njohjen dhe implementimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombetare të kontabilitetit; legjislacionin tatimor dhe tregtar të biznesit;
- metodat e kërkimit shkencor në fushën e financës;
- auditimin financiar në sektorin privat dhe publik.

Në përfundim të këtij programi, të diplomuarit do të fitojnë këto kompetenca profesionale:

- të formulojnë dhe zbatojnë strategji dhe politika për zhvillimin e sektorit financiar;
- të kuptojnë, përpunojnë, analizojnë informacionin kontabël dhe financiar, si dhe të marrin vendime që mundësojnë arritjen e zgjidhjeve të suksesshme të biznesit;
- të ndertojnë ura bashkëpunimi dhe të kontribuojnë me ide për përmirësimin e politikave financiare, në mënyrë që impakti i tyre tek qytetarët të jetë sa më i madh;
- të ofrojnë këshillim dhe asistencë në fushën e kontabilitetit, të shërbimeve të sigurisë, manaxhimit të riskut, auditim, banka tregtare dhe investuese legjislacionit tatimor, konsulencë ndër të tjera;
- të punojnë në fushat e sipërpërmendura në mënyrë individuale ose/dhe në grup, të bashkëpunojnë në mënyrë etike dhe profesionale me mjedisin e jashtëm, në çdo institucion privat dhe publik, institucione kërkimore-shkencore, institucione shtetërore në nivel qendror dhe lokal;
- të kenë njohuri për përdorimin e sistemeve aktuale të kontabilitetit, duke bërë të mundur

integrimin më të shpejtë të tyre në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar;

g. për planifikimin analitik dhe manaxhimin e projekteve dhe investimeve konkrete.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Tregjet dhe Institucionet Financiare	6
		E Drejtë Biznesi	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	SNK dhe SKK	6
		Analiza e Pasqyrave Financiare	6
		Organizimi i Sistemeve të Kontabilitetit dhe Kontrollit	6
		Auditim	6
		Drejtimi Financiar i Avancuar	6
		Analizë Kosto	6
		Kontabiliteti Financiar i Avancuar	6
		Sistemi Tatimor Tregëtar	6
		Analizë Investimesh	6
		Menaxhim Projektsh	6
		Totali	60
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE	Teoria Moderne e Investimeve	6
		Metodat e Kërkimit Shkencor	6
		Lëndë me zgjedhje: 1. Shërbimet e Sigurisë e Konsulencës 2. Vlerësim Pasurie	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktika	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Mikroteza	18
		Totali	18
Totali			120

I. Programet e Ciklit të Tretë, Master Ekzekutiv (Kliko këtu)

- a. “Master Ekzekutiv” në “Restaurim, Konservim dhe Menaxhim i Trashëgimise Arkitekturore”
 (Program i përbashkët midis universitetit Zoja e Keshillit të Mirë, Universitetit të Firences
 (Itali) dhe UGJ-së)

Titulli akademik i studimit		Diplomë “Master Ekzekutiv” në “Restaurim, Konservim dhe Menaxhim i Trashëgimise Arkitekturore”	
Cikli i studimit		Studime të ciklit të tretë	

Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Italisht, Anglisht
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	1 (një) vit
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kritereve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Masteri Ndërkombëtar "Master në Restaurimin, Konservimin dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Arkitekturore" është një kurs studimi i përbashkët i promovuar nga Universiteti i Firences, Universiteti Katolik NSBC i Tiranës dhe Universiteti i Gjirokastrës Eqrem Çabej.

Kursi synon dhënien e titullit të përbashkët, Diplomë "Master Ndërkombëtar" për "Restaurimin, Konservimin dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Arkitekturore".

Ky program synon të trajnojë profesionistë me aftësi specifike multidisiplinare tekniko-profesionale për të analizuar dhe kuptuar aspektet e ndryshme që lidhen me praktikën e konservimit dhe restaurimit, menaxhimit, vlerësimit dhe komunikimit të trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore. Masteri do të ofrojë aktivitete trajnuese në kuadër të projektit të restaurimit të artefakteve historike, me një hapje drejt linjave të reja operationale në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Integrimi mes kulturës italiane dhe asaj shqiptare do të mundësojë trajnimin e arkitektëve të specializuar aktivë në zonën e Mesdheut, duke ndarë objektivat dhe trajnimin për çështje që lidhen me ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë arkitekturore. Kursi është i organizuar në pesë module të ndara në të ndara në aktivitete mësimore dhe trajnuese me kontribute në nivel ndërkombëtar.

Struktura e programit të studimit

Moduli 1 - 5 kredite

- Trashëgimia dhe diversiteti material dhe jomaterial;
- Trashëgimia materiale dhe jomateriale, diversiteti kulturor;
- Peizazhi kulturor: projekti, konservimi, valorizimi;
- Trashëgimia popullore: projekti, konservimi, valorizimi;
- Trashëgimia dhe projekti bashkëkohor;
- Seminar/konferencë: Roli i historisë dhe traditave kulturore në përcaktimin e profilit arkitektonik të qyteteve

Moduli 2 - 10 kredite

Mjete për dokumentimin, diagnostikimin, menaxhimin dhe komunikimin e aseteve

- Teknologji dixhitale për anketim;
- Leximi, interpretimi strukturor dhe diagnostikimi;

- c. Bazat e të dhënave (GIS);
- d. Menaxhimi i të Dhënave të Ndërtesës Historike (HBIM);
- e. Karakteristikat e materialeve, njohja dhe format e degradimit;
- f. Praktika 1: Teknika të avancuara të studimit të trashëgimisë arkitekturore;
- g. Seminar/konferencë: Mjete të avancuara dhe teknologji të reja për dokumentimin, diagnostikimin, menaxhimin dhe komunikimin e trashëgimisë

Moduli 3 - 10 kredite

Metodologjitë dhe teknikat e restaurimit dhe ruajtjes

- a. Evolucioni i teorive të restaurimit;
- b. Mjetet dhe metodat diagnostikuese;
- c. Praktikat e ndërhyrjes në trashëgiminë historike dhe monumentale;
- d. Praktikat e ndërhyrjes në trashëgiminë moderne;
- e. Konsolidimi strukturor;
- f. Praktika 2: Diagnostifikimi për projektin e restaurimit;
- g. Seminar/konferencë: Evolucioni rregullator për mbrojtjen e trashëgimisë

Moduli 4 - 8 kredite

Trashëgimia, rreziku, ndryshimet klimatike dhe elasticiteti

- a. Restaurimi i zonave arkeologjike;
- b. Restaurimi i parqeve dhe kopshteve;
- c. Restaurimi i qendrave urbane;
- d. Objektet historike;
- e. Restaurimi strukturor;
- f. Workshopi 3: Rreziku sizmik;
- g. Konferenca: Trashëgimia, UNESCO dhe Objektivat e Zhvillimit të Përputhshëm.

Moduli 5 - 10 kredite

Menaxhimi i vendeve për Listën e Trashëgimisë Botërore

- a. Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë: Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore;
- b. Plani i Menaxhimit dhe Plani i Veprimit;
- c. Raporti Periodik dhe Monitorimi;
- d. Vlerësimi i ndikimeve: Vlerësimi i ndikimit të shteteve të ruajtjes dhe trashëgimisë

Analizat ekonomike dhe metodat e zbatimit;

- e. Workshop: HIA (Vlerësimi i ndikimit të trashëgimisë);
- f. Seminar/konferencë: Trashëgimia botërore: menaxhimi dhe konservimi.